

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fejzullah Rexhepi kryetar, Ramë Hyseni dhe Qerim Ademaj anëtarë, në çështjen juridike të paditësit F.I. të cilin e përfaqëson me autorizim N.M., avokat nga ..., kundër te paditurës Kompania e Sigurimeve ‘NN’ në Prishtinë, te cilën e përfaqëson me autorizim F.A., në çështjen për kompensim të dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1660/08, të datës 21.06.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datën **14.02.2017**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**APROVOHET si pjesërisht e themeltë** ankesa e të autorizuarit të paditurës Kompania e Sigurimeve “NN” me seli në Prishtinë, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1660/08 të datës 21.06.2013, **NDRYSHOHET** sa i përket pikës I. të dispozitivit, për kompensimin në emër të dhimbjeve të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe gjykon shumën prej 2500.00€, si dhe pjesa që ka të bëjë me kamatën si në pikën II. të dispozitivit, ashtu që gjykon dhe duhet të jetë: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 21.06.2013, e deri në pagesën definitive, ndërsa aktgjykimi i atakuar në pjesën tjetër si në pikën I. pikën III. dhe pikën IV. të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1660/08 të datës 21.03.2013, pjesërisht ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit F.I. si të bazuar, I. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve ‘NN’ në Prishtinë, që paditësit, në emër te kompensimit te dëmit të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me datën 19.04.2007, t’ia paguajë shumat e specifikuara si: dëmin jo material kompensim në emër të dhimbjeve trupore fizike, shumën prej 3.500 Euro, kompensimin në emër të frikës, së përjetuar shumën prej 2.500 Euro, kompensimin në emër të dhimbjeve shpirtërore për shëmtimin trupor shumën prej 2.500 Euro, kompensim në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për shumën prej 4.000Euro. Dëmi material: kompensim në emër të dëmtimit të automjetit shumën prej 1.649.20 Euro. II. Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “NN” në Prishtinë, që paditësit, ti paguaj edhe kamatën vjetore prej 3.5 %, duke filluar nga data 21.06.2013, e deri në pagesën definitive. III. Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë dhe atë në emër të kompensimit për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë, shumën prej 350 Euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 150 Euro, për rehabilitimin klimatik dhe terapisë fizikale prej 300 Euro, si e pa bazuar. IV. Detyrohet e paditura që paditësit ti paguaj edhe shpenzimet e procedurës në lartësi

prej 1008 Euro, e të gjitha në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i të paditurit, për shkak të: shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe vendimit mbi shpenzimet, me propozim që të priset aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.1660/08, të datës 21.06.2013, dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo të ndryshohet aktgjykimi dhe gjykata e shkallës së dytë të vendos vetë lidhur me kërkesëpadinë.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 të LPK-së dhe gjeti se:

### **-Ankesa është pjesërisht e themeltë**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi ka ushtruar padi ndaj të paditurës, me kërkesë për kompensim dëmit material dhe jo material. Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës kryesore dhe administrimit të provave vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 154, 178 dhe nenit 200 të LMD-së, sa i përket kamatës është vendosur në bazë të nenit 186 dhe 277, të LMD-së, ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata është bazuar në nenin 449 dhe 452, të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes si në pikën I. të dispozitivit, për kompensimin në emër të dhimbjeve të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, ka gjetur se ka pasur tejkallim të kërkesëpadiës nga neni 182 par.2, pika o), pasi nga precizimi i kërkesëpadiës si në parashtresën e datës 01.10.2012, ku në emër të dhimbjeve të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor është kërkuar shuma prej 2500.00€, ndërsa është aprovuar në shumën prej 4000.00€, që do të thotë se është tejkalluar kërkesëpadija e paditësit. Gjykata e Apelit ka vendosur të ndryshoj aktgjykimi e atakuar, sa i përket pikës I. të dispozitivit, pasi shkelja nuk ka cenuar ligjshmërinë e aktgjykimit të atakuar, si dhe sa i përket dispozitës së nenit 277 të LMD-së, sa i përket caktimit të kamatës.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar, sa i përket pikës I. të dispozitivit, për kompensimin në emër të dhimbjeve të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe ka gjykuar shumën prej 2500.00€, në tërësi sipas precizimit të kërkesëpadiës, si në parashtresën e datës 01.10.2012, duke e vlerësuar se kjo shumë është gjykim i drejtë i kompensimit në të holla, duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret e posaçërisht natyrën e lëndimeve të rënda trupore dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor me 5% sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë dhe se ky lloj i kompensimit përfaqëson satisfacion i cili shërben për vendosjen e baraspeshës me rëndësinë e shkeljes së të mirave të paditësit dhe qëllimit se ky kompensim ka efekt të shpërblimit jo material dhe nuk ka karakter të shpërblimit material.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, të atakuar në pjesën tjetër si në pikën I. dhe pikën IV. të dispozitivit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka vërtetuar gjendjen faktike e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore dhe kështu e kishte një pasqyrë reale mbi gjendjen në këtë çështje juridike, për këto arsye aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë, është vërtetuar në pjesën tjetër si në pikën I. dhe pikën IV. të dispozitivit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, ka vendosur drejtë, pasi paditësit i takon e drejta në kompensim të dëmit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 323 të LPK-së, nenit 154, 178 dhe 200 të LMD-së<sup>1</sup>, andaj shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar për paditësin F.I., për dhimbjet fizike të përjetuara shumë prej 3500.00 euro, për frikën e përjetuar shumë prej 2500.00 euro, për kompensimin në emër të dhimbjeve shpirtërore për shëmtim trupor në shumë prej 2500.00€, si dhe kompensim në emër të dëmtimit të automjetit shumë prej 1649.20€, të cilin qëndrim e pranon edhe Gjykata e Apelit dhe konsideron se vendosja si në aktgjykim është gjykim i drejtë i kompensimit në të holla, duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret e posaçërisht kohëzgjatjen dhe intensitetin e këtyre dhimbjeve dhe se ky lloj i kompensimit përfaqëson satisfakcion i cili shërben për vendosjen e baraspeshës me rëndësinë e shkeljes së të mirave të paditësit dhe qëllimit se ky kompensim ka efekt të shpërblimit jo material dhe nuk ka karakter të shpërblimit material. Së fundi nga mendimi i ekspertëve të mjekësisë rrjedh se lëndimet e pësuar janë të natyrës së rëndë trupore dhe si pasojë e në përputhje me natyrën e lëndimeve shuma e gjykuar në emër të kompensimit të dëmit jo material është në përpjesëtim dhe në harmoni me natyrën e synimeve të pajtueshme me natyrën e tyre.

Gjykata e Apelit pretendimet ankimore sipas ankesës të ushtruar nga i autorizuari i të paditurës i konsideron si të pa bazuara, pretendimi ankimor se shumat e gjykuara janë shumë të larta dhe tejkalojnë qëllimin e kompensimit të dëmit, ky pretendim për Gjykatën e Apelit është i pa bazuar, për faktin se gjykata e shkallës së parë sa i përket dëmit jo material ka vendosur sipas kërkesëpadisë së paditësit, si në dispozitiv të aktgjykimit duke u bazuar në ekspertizën e dhënë me datë 19.09.2012, nga ekspertët dr. XH.S., ortoped-traumatolog dhe dr. N.I., psikiatër, të cilët kanë vlerësuar se paditësi F.I. në aksidentin e datës 19.04.2007, ka pësuar lëndime të rënda trupore të cilat kanë shkaktuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të rënda 40 minuta, dhimbje të intensitetit të rëndë të në kohëzgjatje 2 ditë, dhimbje të intensitetit të mesëm që kanë zgjatur 21 ditë dhe dhimbje të intensitetit të ulët ka në vazhdimësi, frika primare ka ekzistuar për disa sekonda, frika sekondare të intensitetit të lartë ka zgjatur 2 ditë dhe frika sekondare e intensitetit të ulët 3 muaj, ndërsa shëmtimi trupor i shkallës së mesme që manifestohet me vrazë prej 2cm në pjesën e majtë të hundës, 1,5cm mbi vetullën e majtë dhe dy vraga nga 1cm, në skajin e majtë të vetullës së majtë, duke marrë parasysh natyrën e lëndimeve të pësuar, dhimbjet dhe frikën e përjetuar Gjykata e Apelit vlerëson se shumat e gjykuara janë reale dhe në harmoni me praktikën gjyqësore.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket dëmit material, për kompensimin në emër të dëmtimit të automjetit dhe detyrimin e të paditurës që paditëse ti kompensoj shumë prej

---

<sup>1</sup> LMD-së-ligji për marrëdhëniet e detyrimeve publikuar në GZ të RSFJ-së nr.29, dt.26.05.1978,

1.649.20 Euro, është në tërësi bazuar duke u bazuar në ekspertizën për vlerësimin e dëmit material në automjetin Wolsfagen golf 19 E, e ekspertit R.SH. të datës 15.02.2013, e cila ekspertizë dhe shuma prej 1.649.20 Euro, nuk është kontestuar nga e paditura as gjatë shqyrtimit, si dhe nuk ka pasur pretendime ankimore, andaj edhe nuk do të arsyetohet në mënyrë të veçantë.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar së sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë dhe obligimit të paditurës si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për kompensimin e dëmit palës paditëse, në bazë të provave të administruara nuk është kontestuese, por në këtë drejtim nuk ka pasur pretendime ankimore, andaj gjykata nuk do të arsyetoj aktgjykimin në këtë aspekt.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar sa i përket gjykimit për kamatë, pasi aktgjykimi i shkallës së parë në pikën II palës paditëse i ka njohur të drejtën me kamatën vjetore prej 3.5%, për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë duke filluar nga data 21.06.2013, e deri në pagesën përfundimtare, ndërsa duke u bazuar në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (ligji i vjetër i aplikueshëm në këtë rast), sipas nenit 277, është ndryshuar pjesa që ka të bëjë me kamatën si në pikën II të dispozitivit ashtu që ka gjykuar: me kamatë e cila vlen si për mjetet e deponuara në bankat që operojnë në Kosovë, në afat prej një vit pa destinim të caktuar, duke filluar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë datë 21.06.2013, e deri në pagesën definitive.

Gjykata e Apelit vlerëson se sa i përket shpenzimeve të procedurës me të cilat e paditura është obliguar që t'ua kompensoj paditësit në shumën prej 1008.00euro, është vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pasi nga shkresat e lëndës rezulton se janë arsyetuar në tërësi nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se vendosja si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar sa i përket pjesës refuzuese si në pikën III të dispozitivit, është vërtetuar dhe ka mbetur e pa shqyrtuar pasi pala paditëse nuk ka ushtruar ankesë, ndërsa pala e paditur nuk ka interes që aktgjykimi të goditet në këtë pjesë.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 195.1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**Ac.nr.3350/2013, më datë 14.02.2017**

**Kryetari i kolegjit-gjyqtari**  
*Fejzullah Rexhepi*